

Çfarë veprimesh duhen ndërmarrë për ta parandaluar ?

Depistimi :

Propozohet nga Qendra e luftës kundër tuberkulozit e departamentit :

- për personat që udhëtojnë shumë;
- në disa bashkësi të caktuara;
- në raste të deklaruara të tuberkulozit.

Vaksinimi :

Vaksina e BCG-së rekomandohet për fëmijët që paraqesin një rrezik të lartë ndaj sëmundjes.

Kjo vaksinë nuk të mbron 100 % por lejon të shmangen format e rënda të tuberkulozit të fëmijës siç është meningjiti.

Për më shumë informacion, mund t'i drejtoheni Qendrës së Luftës Anti-Tuberkuloz (CLAT) të sektorit tuaj :

Centre Hospitalier de Dax-Côte d'Argent
CLAT - Centre de Lutte AntiTuberculeuse
4 bis rue Labadie
40100 Dax
☎ 05 58 57 92 60
Mail : cdag40@ch-dax.fr



tuberculose

TUBERKULOZI

Një sëmundje infektuese që është ende e kohës dhe që

transmetohet me rrugë ajrore mund të jetë ngjitëse edhe pa qenë në dijeni shërohet me antibiotikë të përshtatshëm

Ç'është tuberkulozi ?

Është një sëmundje infektuese e shkaktuar nga një mikrob : Bacili i Kokut(BK)

Kjo sëmundje prek kryesisht mushkrittë (80 % e rasteve) por ajo mund të prekë edhe organe të tjera : gjendrat, kockat, veshkat, organet gjenitale, trurin...

- gjendrat
- kockat
- veshkat
- organet gjenitale
- trurin

Cilat janë shenjat e tij ?

- Ndonjëherë asnjë shenjë e veçantë,
- Ndonjëherë një kollë e pandërprerë,
- Ndonjëherë temperaturë,
- Ndonjëherë djersë gjatë natës,
- Ndonjëherë humbje peshe,
- Ndonjëherë një lodhje e madhe,
- Ndonjëherë pështymë me gjak.

Sëmundja nis në mënyrë progressive, zhvillimi i saj është i ngadaltë, shkon disa javë.

Si përçohet mikrobi ?

Një i sëmurë me tuberkuloz i përçon bacilet duke u kollitur, duke pështyrë, duke teshtitur, duke kënduar, ose thjesht duke folur.

Këto mikrobe mbeten të pranishme, të padukshme, në ajrin e mjedisit përfaq. Rreziku i ngjitjes varet nga kohëzgjatja dhe frekuenca e kontakteve.

Sa më i gjatë dhe i shpeshtë të jetë kontakti me një të sëmurë me këtë sëmundje ngjitëse, aq më i madh është rreziku për t'u infektuar.

Tuberkulozi mund të mjekohet !

dhe mund të shërohet plotësisht me kusht që të ndiqet me rreptësi mjekimi.

Disa antibiotikë merren çdo ditë për një periudhë prej së paku 6 muaj.

Ndalimi para kohe i mjekimit çon në një përtëritje të sëmundjes, e bën përsëri ngjitëse atë dhe mund të sjellë rrezikun që antibiotikët të mos bëjnë më asnjë efekt.

Rreziku është më i madh tek fëmijët dhe të moshuarit.

Si bëhet diagnostikimi ?

- Me pyetje dhe me vizitë mjekësore
- Me një test tuberkulinë nën lëkurë : Turbotesti
- Përmes kërimit të Bacilit Tuberkular duke marrë një mostër : pështymë më shpesh, urinë, gjendër...